



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Nr. 012/2021
Datë: 29.03.2021

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 6 (2.1) dhe nenin 11 (1) të Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) - Nr. 07/2020, nxjerr:

V E N D I M

1. Z. Getoar Mjeku emërohet Zëvendësministër në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
2. Zëvendësministri emërohet për mbështetjen e Ministres së Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe është përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve në fushat e përcaktuara nga Ministri, si dhe për zëvendësimin e Ministrit kur ai mungon ose kur nuk është në gjendje të kryejë detyrën e tij.
3. Zëvendësministri, brenda tridhjetë (30) dite nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi është i obliguar të bëjë deklarinimin e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-050 për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- Z. Getoar Mjeku, Zëvendësministër, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Të gjithë Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë Ministrave;
- Shefit të stafit të Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.